

Burime Udhëzuese për Trainuesit e Ndhmës Sociale: Mësimet 1, 2 dhe 10.

Menaxherët e Ndhmës Sociale të Zonës, Specialistët e Mirëqenies të Zonës, Specialistët e Ndhmës Sociale të Rajonit, Komitetet e Mirëqenies të Rajoneve, Kunjeve dhe Lagjeve



KISHA E
JEZU KRISHTIT
E SHENJTORËVE TË
DITËVE TË MËVONSHME

Piktura në kopertinë: *Krishti Duke Shëruar të Sëmurët në Betesda*, nga Karl Hajnrih Bloh.
Me mirësjellje nga Muzeu i Artit në Universitetin Brigam Jang.

© 2004–2007 nga Intellectual Reserve, Inc.

Të gjitha të drejtat i rezervohen.

Shtypur në Gjermani.

Miratimi në anglisht: 2/07

Miratimi për përkthim: 2/07

Përkthim i *Instructional Resources for Welfare Trainers: Mësimet 1, 2 dhe 10.*

Albanian

37058 101

PËRMBAJTJA

Hyrje	iv.
1. Mirëqenia Shpirtërore dhe Materiale	1
2. Mbështetja tek Vetja	3
10. Duke Ndhmuar të Tjerët të Bëhen më të Pavarur	7

HYRJE

Përdorimi i Këtij Manuali

Ky manual është një burim udhëzimesh për komitetet rajonale, të kunjeve dhe të lagjeve dhe për këshillat e mirëqenies të peshkopëve të kunjeve. Mësimet në këtë manual japin njohuri mbi parimet e mirëqenies shpirtërore dhe materiale dhe përgjegjësitë e peshkopëve, të udhëheqësve të Priftërisë Melkizedeke dhe të udhëheqësve të Shoqatave të Ndihmës. Të ndihmuar nga Shpirti, udhëheqësit duhet të planifikojnë dhe të zhvillojnë këto mësimet për të ndihmuar në përgjigje të nevojave shpirtërore, emocionale dhe materiale të anëtarëve në kunjat, distriktet, lagjet apo degët e tyre.

Videokaseta *Essentials of Welfare* (Bazat e Ndimës Sociale (5x045) ose DVD *In the Service of Your God* (Në Shërbim të Perëndisë Tuaj) (54645) sugjerohen për t'u përdorur në shumë nga mësimet. Kjo videokasetë apo DVD mund të porositet nëpërmjet shërbimeve të shpërndarjes të Kishës. Ndihmë tjetër për mësimdhënien në këtë manual përfshin një listë materialesh për çdo mësim, citime nga manualet e Kishës, referenca nga shkrimet e shenjta, pyetje të mundshme për diskutim dhe sugjerime të tjera për pjesëmarrje në klasë. Sugjerime shtesë për mësimdhënien mund të gjenden në *Teaching Guidebook* (34595) dhe në *Teaching, No Greater Call* (36123).

Nxitje e Diskutimit në Klasë

Më mirë se sa t'i paraqisni si leksione këto mësimet, i ndihmoni anëtarët e klasës të marrin pjesë duke u shprehur në diskutimin e pikave kyçe të mësimet, të shkrimeve të shenjta dhe të manualeve të Kishës. Kur anëtarët e klasës aktivizohen, ata mësojnë me më shumë efikasitet pikat kyçe të mësimet dhe kuptojnë më mirë se si të zbatojnë parimet e ungjillit. Kërkoni drejtimin e Shpirtit në vendosjen se çfarë pyetjesh të bëni, si t'i organizoni dhe si t'i diskutoni ato. Diskutimet e klasës duhet të përqendrohen në çështje që ndihmojnë anëtarët të vijnë tek Krishti dhe të jetojnë si dishepujt e Tij. Riorientoni diskutimet që nuk u përgjigjen këtyre qëllimeve. Për më shumë ide mbi mësimin duke drejtuar pyetje, shih *Teaching, No Greater Call*, 68–70.

Përdorni drejtimet e mëposhtme për të nxitur diskutimin në klasë:

1. Pasi të bëni një pyetje, u jepni anëtarëve të klasës një referencë nga shkrimet e shenjta që të mund të gjejnë përgjigjen.
2. Drejtoni pyetje që kërkojnë mendim dhe diskutim më shumë se sa përgjigje *po* ose *jo*. Pyetje që fillojnë me *pse*, *si*, *kush*, *çfarë*, *kur*, dhe *ku* janë zakonisht shumë efikase për të nxitur diskutimin.
3. Inkurajoni nxënësit që të flasin për atë që ndiejnë mbi çka po mësojnë nga mësimi. Gjithashtu i inkurajoni të ndajnë përvojat që tregojnë se si parimet e mirëqenies mund të zbatohen në thirrjet e tyre. Bëni komente pozitive mbi kontributet e tyre. Sidoqoftë, nëse thuhet diçka në kundërshtim me doktrinën e Kishës, siguroni që pasaktësia e informacionit të korrigjohet. Këto parime të rëndësishme të mirëqenies janë të shenjta dhe nuk duhet të dobësohen, të ndryshohen apo të keqkuptohen. Riorientoni deklaratimet apo diskutimet që nuk ftojnë Shpirtin, duke përdorur dashuri dhe butësi, lidhur me parimet e drejta (shih *Teaching, No Greater Call*, 84–87).
4. Jini të ndjeshëm ndaj nevojave të secilit nxënës. Megjithëse të gjithë nxënësit duhet të inkurajohen të marrin pjesë në diskutimet e klasës, disa mund të ngurojnë të përgjigjen. Ju mund të doni të flisni personalisht me ta për të ditur se si ndihen ata me leximin me zë të lartë ose me pjesëmarrjen në mësim. Jini të kujdesshëm të mos i ftoni ata që mund të ndihen në vështirësi.

1 MIRËQENIA SHPIRTËRORE DHE MATERIALE

Objektivi

Çdo pjesëmarrës do të zotohet të fillojë të përmirësojë mirëqenien e tij/saj shpirtërore dhe materiale.

Materiale për Këtë Mësim

In the Service of Your God (Në Shërbim të Perëndisë Tuaj) DVD (54645)

Deklaratë nga

Church Handbook of Instructions
(Manuali i Udhëzimeve të Kishës)

Ftoni një pjesëmarrës të lexojë deklaratën e mëposhtme:

“Marrja e përgjegjësisë vetjake për mirëqenien shpirtërore dhe materiale gjithnjë ka qenë pjesë e të jetuarit sipas ungjillit...”

“Parime për përmirësimin e mirëqenies shpirtërore përfshijnë:

“Të kesh besim në Jezu Krisht...”

“Të marrësh ordinancat e shpëtimit ...

“Të lutesh çdo ditë dhe të studjosh ungjillin ...

“T’u bindesh urdhërimeve të Perëndisë ...

“Të duash Perëndinë dhe të duash dhe t’u shërbesh të tjerëve ...

“Forcimin e familjes duke u lutur së bashku, duke studjuar shkrimet e shenja të bashku dhe duke dashur dhe duke u kujdesur për njëri tjetrin.

“Të marrësh pjesë në mbledhjet e Kishës ...

“Të ndash ungjillin me miqtë dhe të afërmit ...

“Të gjesh dhe të paraqesësh emrat e paraardhësve të vdekur për ordinancë tempulli ...

“Parimet për përmirësimin e mirëqenies materiale përfshijnë kujdesin për të varfërit dhe nevojtarët

dhe të bëhesh i aftë të mbështetesh tek vetja dhe si familje” (*Church Handbook of Instructions, Book 2: Priesthood and Auxiliary Leaders* [1998], 255).

I pyesni pjesëmarrësit: Si na ndihmojnë parimet e mirëqenies të bëhemi më shumë si Ati ynë Qiellor dhe Jezu Krishti?

Pika Kyçe: Përcaktimi i Thelbit të Mirëqenies

I ndihmoni pjesëmarrësit të kuptojnë parimet e mëposhtme dhe i diskutoni ato sipas nevojës. Shpjegoni që këto parime janë thelbi i mirëqenies së Kishës:

1. Të gjitha gjërat i përkasin Zotit (shih DeB 104:14).
2. Të gjitha gjërat janë shpirtërore për Zotin (shih DeB 29:34–35).
3. Mirëqenia materiale përfshin ushqimin, veshjen, strehimin, shëndetin, arsimin, punën dhe forcën emocionale.
4. Mirëqenia shpirtërore përfshin adhurimin e Perëndisë, studimin e ungjillit, forcimin e familjes, marrjen e ordinancave dhe shërbimin ndaj të tjerëve (shih *Church Handbook of Instructions, Book 2, 255*).
5. Mirëqenia shpirtërore dhe materiale vijnë kur bëhet vullneti i Zotit siç zbulohet nëpërmjet profetëve të Tij.

Paraqitje me Video: Elia dhe e Veja e Sareptës

Tregoni “Elia dhe e Veja e Sareptës” (pjesa e DVD *In the Service of Your God*), nëse e keni, ose lexoni apo tregoni historinë e Elias dhe të së vesës së Sareptës, që gjendet në 1 Mbretërve 17:2–24 (shih gjithashtu Jeffrey R. Holland, në Conference Report, prill 1996, 38–39; ose *Ensign*, maj 1996, 29).

I pyesni pjesëmarrësit: Çfarë mund të mësojmë nga ky shembull i së vesë? Çfarë bëri ajo që të shpëtonte veten dhe birin e saj shpirtërisht dhe materialisht? Çfarë na ka këshilluar profeti ynë të bëjmë për të përmirësuar mirëqenien tonë shpirtërore dhe materiale? (Përgjigjet mund të përfshijnë: paguaj të dhjetën e plotë; jepni oferta agjërimit bujare; mbani shtëpitë në rregull; jini modest në shpenzime; shmangni borxhet; paguani detyrimet financiare, përfshi hipotekimet; kurseni një sasi; vini mënjane rezervë ushqimore dhe ndihmoni të tjerët. [See Conference Report, tetor 1998, 69–72; or *Ensign*, nëntor 1998, 52–54. Shih gjithashtu Conference Report, tetor 2001, 89–90; ose *Ensign*, nëntor 2001, 73–74.]

Mësime Shtesë nga Udhëheqësit e Kishës

Tregoni deklaratimet e mëposhtme me pjesëmarrësit sipas dëshirës:

“Qëllimi ynë parësor ishte të ndërtonim, për aq sa është e mundur, një sistem në të cilin mallkimi i përtacisë do të zhdukej, e keqja e lëmoshës do të eliminohet dhe pavarësia, puna e zellshme, ekonomia, suksesi dhe respekti për veten do të vendosen përsëri midis njerëzve tanë. Qëllimi i Kishës është të ndihmojë njerëzit të ndihmojnë vetveten” (Presidencia e Parë, në Conference Report, tetor 1936, 43).

“Çdo burri dhe gruaja ... në këtë Kishë që paguan ndershmërisht të dhjetën, qoftë ajo e madhe apo e vogël, unë shpreh mirënjohjen për besimin që është në zemrat tuaja... unë shpreh vlerësimin për ata që japin ofertën e agjërimit. Kjo nuk i kushton tjetër dhënësit të saj përveç qëndrimit pa ushqim dy vakte në muaj. Ajo bëhet shtylla e programit tonë të mirëqenies” (Gordon B. Hincley, në Conference Report, tetor 2001, 90; ose *Ensign*, nëntor 2001, 74).

“Le të vendosim mënjane një sasi ushqimi që do të na mbajë për një kohë në rast nevojë. Por mos të biem në panik apo të kalojmë në ekstreme. Le të jemi të kujdesshëm në çdo drejtim” (Gordon B. Hincley, në Conference Report, tetor 2001, 89; ose *Ensign*, nëntor 2001, 73).

“Shumë njerëz në Kishë kanë dështuar të shmangin borxhe të panevojshme. Ata kanë rezervë financiare të pakta ose nuk kanë fare. Zgjidhja është të shpenzojmë duke jetuar brenda mundësive tona dhe të kursejmë diçka për të ardhmen” (Thomas S. Monson, “Guiding Principles of Personal and Family Welfare,” *Ensign*, shtator 1986, 3).

“Qëllimi i programit të mirëqenies është të kujdesemi për të varfërit dhe ata në nevojë dhe të bëjmë që anëtarët e Kishës, me bindjen e tyre ndaj parimeve të ungjillit, të jenë të fortë dhe që mbështeten tek vetja” (James E. Faust në Conference Report, prill 1986, 24; ose *Ensign*, maj 1986, 20).

Praktikë

Ftoni pjesëmarrësit të vlerësojnë personalisht se si po i ndjekin këshillat e profetit dhe të udhëheqësve të tjerë të Kishës mbi mirëqenien shpirtërore dhe materiale. I ftoni të zgjedhin një ose dy fusha ku ata mund të përmirësohen dhe të bëjnë e zbatojnë plane të veçanta për të filluar një përmirësim të menjëhershëm.

Dëshmoni që bekimet nga ndjekja e këshillave të profetit janë edhe shpirtërore edhe materiale.

2 MBËSHTETJA TEK VETJA

Objektivi

Çdo pjesëmarrës do të zotohet të mbështetet më shumë në vetvete.

Materiale për Këtë Mësim

Kopje të Ushtrimit të Mbështetjes tek Vetja (që shoqërojnë këtë mësim) për secilin pjesëmarrës.

Deklaratë nga

Church Handbook of Instructions (Manuali i Udhëzimeve të Kishës)

Ftoni një pjesëmarrës të lexojë deklaratën e mëposhtme:

“Shpëtimtari ka urdhëruar Kishën dhe anëtarët e saj të mbështeten tek vetja dhe të jenë të pavarur.

“Që një njeri të arrijë të mbështetet në veten e tij duhet të punojë. Puna është një përpjekje fizike, mendore ose shpirtërore. Ajo është një burim themelor i lumturisë, i vetëvlerësimit dhe i përparimit. Nëpërmjet punës, njerëzit plotësojnë shumë gjëra të mira në jetën e tyre...

“Kur njerëzit mund të mbështeten në veten e tyre, ata janë të përgatitur më mirë për të përballuar fatkeqësitë [dhe janë] më të aftë të kujdesen për të tjerët në nevojë” (*Church Handbook of Instructions, Book 2: Priesthood and Auxiliary Leaders* [1998], 257).

I pyesni pjesëmarrësit: Çfarë do të thotë mbështetje tek vetja? (Mbështetje tek vetja do të thotë të përdorësh të gjitha bekimet që kemi nga Ati Qiellor për t’u kujdesur për veten dhe familjet dhe të gjejmë zgjidhje për problemet tona.)

I pyesni pjesëmarrësit: Si ndodh që ne bëhemi individë, anëtarë familjeje, miq, anëtarë Kise, qytetarë dhe dishepuj të Krishtit më të mirë, kur mundemi të mbështetemi në veten tonë?

Shkrim i Shenjtë

Ftoni një pjesëmarrës të lexojë shkrimin e shenjtë të mëposhtëm:

“Por në qoftë se dikush nuk kujdeset për të vetët, dhe më tepër për ata të shtëpisë, ai e ka mohuar besimin dhe është më i keq se një jo besimtar” (1 Timoteut 5:8).

I pyesni pjesëmarrësit: Përse mendoni ju se Pali thotë që një person që nuk siguron për vehte ka mohuar besimin?

Pika Kyçe

I ndihmoni pjesëmarrësit të kuptojnë pikat e mëposhtme dhe t’i diskutojnë kur duhet:

1. Zgjedhja e lirë është themelore në planin e Krijuesit tonë (shih DeB 58:26–28; 2 Nefi 2:27).

I pyesni pjesëmarrësit: Cila është lidhja midis zgjedhjes së lirë dhe mbështetjes tek vetja?

2. Mbështetja tek vetja është thelbësore në kujdesin për familjet tona dhe për vetveten. “Ati Qiellor u ka dhënë të gjithë fëmijëve të Tij gjithçka që kanë—talentet, aftësitë dhe të mirat materiale—dhe i ka bërë kujdestarë të këtyre bekimeve (shih DeB 104:11–13). Për të përmbushur me nder këtë përkujdesje, anëtarët e Kishës duhet të mbështeten në vetvete, duke përdorur këto bekime të kujdesen për veten dhe familjet e tyre” (*Church Handbook of Instructions, Book 2, 257*).

3. Mbështetja në vetvete është thelbësore për t’u kujdesur për të tjerët. Presidenti Marion G. Romney mësoi: “Pa mbështetje tek vetja nuk mund të plotësosh këto dëshira të brendshme për të shërbyer. Si mundemi të japim nëse nuk kemi asgjë? Ushqim për të uriturin nuk mund të merret nga dollapet bosh. Paratë për të ndihmuar nevojtarin nuk mund të dalin nga një

portofol bosh. Mbështetja dhe kuptimi nuk mund të merren nga dikush që është emocionalisht i varfër. Mësim nuk mund të vijë nga një i pamësuar. Dhe më e rëndësishmja nga të gjitha, udhëheqja shpirtërore nuk mund të vijë nga një njeri që është i dobët shpirtërisht” (në Conference Report, tetor 1982, 135; ose *Ensign*, nëntor 1982; 93). Megjithatë, ne nuk duhet të presim derisa të jemi plotësisht të mbështetur tek vetja që t’u shërbejmë të tjerëve.

I pyesni pjesëmarrësit: Ku qëndron ndryshimi midis mbështetjes në vetvete dhe materializmit apo synimit për pasurim? (shih Jakobi 2:18–19.)

4. Kisha inkurajon anëtarët e saj të mbështeten tek vetja në këto gjashtë fusha: arsim dhe shkrim e këndim, shëndet fizik, punësim, rezerva shtëpiake, menaxhim burimesh dhe forcë shpirtërore, emocionale dhe shoqërore (shih *Church Handbook of Instructions, Book 2*, 257–58).

Historia e Familjes Kastaneda

Lexoni (ose i kërkoni një pjesëmarrësi të lexojë) historinë që shoqëron këtë mësim. Diskutoni me pjesëmarrësit se si të jetuarit sipas ungjillit e ndihmoi këtë familje të mbështetet tek vetja.

Diskutoni se si ky shembull lidhet me rrethanat e vetë pjesëmarrësve.

Mësime Shtesë nga Udhëheqësit e Kishës

Diskutoni deklaratimet e mëposhtme sipas dëshirës:

“Ne të gjithë duhet të shohim për vetëmjaftueshmëri më të madhe, shpirt më të madh pavarësie, dëshirë më të madhe për t’u kujdesur për veten dhe njerëzit tanë” (Gordon B. Hinckley, në Conference Report, tetor 1982, 111; ose *Ensign*, nëntor 1982, 76).

“Bota do t’i nxirrte njerëzit nga lagjet e varfra. Krishti largon mjerimin nga njerëzit dhe pastaj ata largojnë veten nga mjerimi. Bota do t’i formonte njerëzit duke ndryshuar ambientin. Krishti ndryshon njerëzit, të cilët pastaj ndryshojnë ambientin e tyre. Bota do të modelonte sjelljen njerëzore, por Krishti mund të ndryshojë natyrën njerëzore” (Ezra Taft Benson, në Conference Report, tetor 1985, 5; ose *Ensign*, nëntor 1985, 6).

“Asnjë shenjtor i ditëve të mëvonshme i vërtetë, duke qenë fizikisht apo emocionalisht i aftë, nuk do t’ia hidhte me dashje barrën e mirëqenies së tij ose të familjes së tij dikujt tjetër. Për sa kohë që mundet, me frymëzimin e Zotit dhe me punën e tij, ai do të sigurojë për veten dhe familjen e tij lidhur me nevojat shpirtërore dhe materiale të jetës.” (Spencer W. Kimball, në Conference Report, tetor 1977, 124; ose *Ensign*, nëntor 1977, 77–78).

“Ne kemi patur sukses shumë të mirë në ngulitjen në mendjet e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme që ata duhet të kujdesen për nevojat e tyre materiale dhe pastaj të kontribuojnë për mirëqenien e atyre që nuk mund të sigurojnë nevojat e jetesës. Nëse një anëtar është i paaftë të mbajë veten, atëherë ai duhet t’i drejtohet familjes së tij, dhe pastaj Kishës, sipas kësaj radhe” (Boyd K. Packer, “Self-Reliance,” *Ensign*, gusht 1975, 85).

Praktikë

U jepni pjesëmarrësve një kopje të Ushtrimit të Mbështetjes tek Vetja që shoqëron këtë mësim dhe u kërkoni ta plotësojnë. Inkurajoni pjesëmarrësit të zotohen të bëhen më të pavarur duke bërë plane të veçanta për t’i zbatuar idetë që shkruajtën gjatë ushtrimit.

Jepni dëshmi mbi përfitimet nga mbështetja tek vetja.

Historia e Familjes Kastaneda

Më lejoni t'ju tregoj një histori që e kam dëgjuar kohët e fundit në Meksikë. Në Torrehon më transportuan me një makinë të mrekullueshme që i përkiste burrit për të cilin po flas. Emri i tij është David Kastaneda.

Tridhjetë vite më parë ai, bashkëshortja e tij, Tomasa dhe fëmijët e tyre jetonin në një fermë të vogël të thatë dhe të varfëruar pranë Torrehonit. Ata kishin 30 pula, 2 derra dhe një kalë të dobët. Pulat jepnin pak vezë për t'i mbajtur ata dhe mundësinë e rastit për të fituar ndonjë pezo. Ata jetonin në varfëri. Pastaj misionarët i vizituan ata. Motra Kastaneda tha: "Eldrat na hoqën perdet nga sytë dhe na sollën dritë në jetën tonë. Ne nuk dinim asgjë për Jezun Krishtin. Ne nuk dinim asgjë për Perëndinë deri sa erdhën ata."

Ajo kishte dy vite shkollë, bashkëshorti i saj asnjë. Eldrat u dhanë mësimë atyre dhe përfundimisht ata u pagëzuan. Ata u çvendosën në qytetin e vogël të Bermehilos. Ata u futën me mbarësi në biznesin e vjetërsirave, duke blerë automobila të prishur. Kjo i drejtoi ata në shoqëri me kompani sigurimesh dhe me të tjerë. Gradualisht ata ndërtuan një biznes të begatë ku punonin babai dhe pesë bijtë e tij. Me besim të qartë ata paguan të dhjetën e tyre. Ata vunë besimin e tyre tek Zoti. Ata jetuan sipas ungjillit. Ata shërbyen kudo që u thirrën të shërbejnë. Katër nga djemtë e tyre dhe tre nga vajzat kryen mision. Djali më i ri tani po shërben në Oaksaka. Ata kanë ndërtuar tani një biznes shumë të fortë dhe janë begatuar me të. Ata u përqeshën nga kritikët e tyre. Përgjigjja është një dëshmi e fuqisë së Zotit në jetën e tyre.

Rreth 200 familjarë dhe miq janë bashkuar me Kishën në sajë të ndikimit të tyre. Mbi 30 bij dhe bija të familjes dhe të miqve kanë kryer misione. Ata dhuruan vendin ku tani ndodhet një kishë.

Fëmijët, tani në moshë pjekurie dhe prindërit shkojnë me radhë në Meksiko Siti çdo muaj për të shërbyer në tempull. Ata qëndrojnë si një dëshmi e gjallë e fuqisë së madhe të kësaj pune të Zotit për të ngritur dhe për të ndryshuar njerëzit. Ata janë përfaqësues tipikë të mijra e mijra të tjerëve nëpër gjithë botën që provojnë mrekullinë e Mormonizmit si një dëshmi e shenjtërisë së punës që vjen në jetën e tyre. [Gordon B. Hinckley, në Conference Report, prill 1998, 91–92; ose *Ensign*, maj 1998, 70]

USHTRIMI I MBËSHTETJES TEK VETJA

Si anëtarë të Kishës, ne duhet të mbështetemi tek vetja në gjashtë fushat e mëposhtme: (1) arsim dhe shkrim e këndim; (2) shëndet fizik; (3) punësim; (4) rezerva shtëpiake; (5) menaxhim i burimeve dhe (6) forcë shpirtërore, emocionale dhe shoqërore (shih *Church Handbook of Instructions, Book 2: Priesthood and Auxiliary Leaders* [1998], 257–258). Zotohuni të bëheni më të pavarur duke i zbatuar ato në jetën tuaj.

Zgjidhni një nga këto gjashtë fusha dhe rendisni më poshtë pesë mënyra që mund të bëheni më i pavarur në atë fushë.

Fusha e mbështetjes tek vetja: _____

Gjëra që mund të bëni për t'u bërë më i pavarur: _____

1. _____

2. _____

3. _____

4. _____

5. _____

10 DUKE NDIHMUAR TË TJERËT TË BËHEN MË TË PAVARUR

Objektivi

Anëtarët e komitetit të mirëqenies dhe specialistët e mirëqenies do të jenë më të aftë të ndihmojnë të tjerët që të bëhen më të pavarur.

Materiale për Këtë Mësim

Analiza e Nevojave dhe e Burimeve (32290, që shoqëron këtë mësim); një kopje për çdo pjesëmarrës

Deklaratë nga

Church Handbook of Instructions (Udhëzime nga Manuali i Kishës)

Ftoni një pjesëmarrës të lexojë deklaratën e mëposhtme:

“Kur anëtarët e Kishës bëjnë çdo gjë që mundën për të siguruar për veten, por përsëri nuk mund t’i plotësojnë nevojat e tyre bazë, ata së pari duhet t’u drejtohen rrethit [të gjerë] të familjes për ndihmë. Kur kjo nuk është e mjaftueshme, Kisha qëndron gati për të ndihmuar” (*Church Handbook of Instructions, Book 2: Priesthood and Auxiliary Leaders* [1998], 256).

Shkrimi i shenjtë

Ftoni një pjesëmarrës të lexojë shkrimin e shenjtë që vijon dhe diskutoni se si sjell gëzim mbështetja tek vetja:

“Dhe secili të analizojë veprën e tij dhe atëherë do të ketë arsye të mburret vetëm për veten e tij dhe jo lidhur me tjetrin. Sepse secili do të mbajë barren e vet” (Galatasve 6:4–5).

Pika Kyçe

Ndihmoni pjesëmarrësit të kuptojnë pikat e mëposhtme dhe i diskutoni kur duhet:

1. Anëtarët kanë përgjegjësi parësore për mirëqenien e tyre shpirtërore, materiale dhe shoqërore. Presidenti Spenser W. Kimball mësoi: “Asnjë Shenjtor i vërtetë i Ditëve të Mëvonshme, duke qenë fizikisht apo emocionalisht i aftë, nuk do t’ia hidhte barrën e mirëqenies së tij ose të familjes së tij dikujt tjetër. Për sa kohë që mundet, me frymëzimin e Zotit dhe me punën e tij, ai do të sigurojë për veten dhe familjen e tij lidhur me nevojat shpirtërore dhe materiale të jetës.” në Conference Report, tetor 1977, 124; ose *Ensign*, nëntor 1977, 77–78).
2. Kur ndihmojmë anëtarët nevojtarë, ne nuk duhet të zëvendësojmë përgjegjësinë që ata kanë për të zgjidhur problemet e tyre. Plaku Marvin J. Ashton dha këtë këshillë për ata që do të ndihmonin të tjerët: “Ai që kupton dhe zbaton me të vërtetë ndjeshmërinë nuk zgjidh problemet e tjetrit, nuk argumenton, nuk zmadhon ngjarjen e tij, nuk ngre akuza apo heq lirinë [e tij] të zgjedhjes. Ai thjesht ndihmon personin të ndërtojë pavarësinë dhe imazhin e tij që të mund të përpiqet të gjejë zgjidhjet e veta” (në Conference Report, tetor 1981, 128–29; ose *Ensign*, nëntor 1981, 91).
3. Plaku Dallin H. Oaks mësoi: “Rritja [individuale] e kërkuar nga plani i ungjillit ndodh vetëm në kulturën e një përpjekjeje dhe përgjegjësie individuale. Nuk mund të ndodhë në kulturën e vartësisë. Çfarëdo që na bën të jemi të varur nga dikush tjetër për vendime apo burime që ne mund t’i sigurojmë për vete na dobëson shpirtërisht dhe vonon rritjen tonë drejt asaj që plani i ungjillit synon të jemi” (në Conference Report, tetor 2003, 42; ose *Ensign*, nëntor 2003, 40).
4. “Qëllimi i Kishës është të ndihmojë njerëzit të ndihmojnë vetveten. Puna duhet të rivendoset në krye si parimi qeverisës i jetës së anëtarëve të Kishës tonë” (Presidencia e Parë, në Conference Report, tetor 1936, 3).

5. Peshkopi ose presidenti i kungjit mund të thërrisë specialistë të ndryshëm të mirëqenies në komitetin e lagjes apo të kungjit për mirëqenien për të ndihmuar anëtarët të arrijnë të mbështeten tek vetja (shih *Church Handbook of Instructions, Book 2, 259–260*).

Pyesni pjesëmarrësit se si ata apo specialistët e mirëqenies në lagjen apo kungjin e tyre kanë ndihmuar anëtarët të arrijnë të mbështeten në veten e tyre. (Kujtojuni atyre të mos nxjerrin informacione konfidenciale.)

6. Peshkopi mund të përdorë modelarin Analiza e Nevojave dhe e Burimeve (që shoqëron këtë mësim) për të ndihmuar anëtarët nevojtarë të fillojnë të bëjnë plane që çojnë në mbështetjen tek vetja. Shpërndani kopje të modelarit dhe jepni një përmbledhje dhe shpjegim të shkurtër për grupin.

7. Mbështetja tek vetja është një proces që përfshin këto hapa:

- Përcaktoni rrethanat aktuale.
- Zgjidhni një qëllim.
- Bëni një plan për ta arritur.
- Përcaktoni burimet e mundshme.
- Ndiqni planin.

Kur dikush nuk është i pavarur, është e rëndësishme ta ndihmojmë të përcaktojë rrethanat dhe shkaqet ekzistuese përpara se të vendosi një objektiv, ndryshe ai mund të mos vendosë për objektivin e duhur.

Pyesni pjesëmarrësit: Si mund të ndihmojnë udhëheqësit anëtarët për të bërë plane të mbështetjes tek vetja? Si mund të ndihmojnë ata anëtarët të realizojnë planet e tyre?

Studimi i një Rasti

Shpërndani kopje të modelarit Analizë e Nevojave dhe e Burimeve dhe lexoni studimin e mëposhtëm të një rasti:

Ju jeni një specialist i mirëqenies i lagjes. Peshkopi ju ka kërkuar të ndihmoni një anëtare të lagjes që ka shkuar për ndihmë tek ai. Ju duhet ta ndihmoni atë të bëhet më e pavarur.

Ajo është beqare, në të dyzetat e para të saj, pa fëmijë. Ajo ka një diplomë në arsim dhe një certifikatë për mësimdhënie. Përsëri, ajo nuk është punësuar me kohë të plotë për shumë vite për shkak problemesh të përhershme shëndetësore. Ajo ka astmë dhe si rrjedhim mungesa e veprimtarisë e ka dobësuar shëndetin e saj. Ajo merr tani pagesa invaliditeti nga qeveria, por ato janë tepër pak që ajo të jetojë me to. Ajo i ka kërkuar peshkopit t'i sigurojë ndihmë financiare shtesë. Kur ju e pyesni se si janë planet e saj për të ardhmen, ajo ju tregon se ajo tashmë po bën gjithçka mundet.

I pyesni pjesëmarrësit të përdorin modelarin Analiza e Nevojave dhe e Burimeve për të ndihmuar këtë person të bëjë plane që do të çonin në mbështetjen tek vetja. Pastaj i ftoni ata të diskutojnë se si do të merreshin me detyrën për të ndihmuar këtë person të mbështetet tek vetja. (Nëse është e nevojshme, u kujtoni hapat e procesit të mbështetjes tek vetja renditur më sipër.) Nëse grupi është i madh, i ndani pjesëmarrësit në grupe më të vegjël diskutimi, pastaj i ftoni të tregojnë mbi idetë që lindën nga diskutimet e tyre.

Praktikë

U kërkoni pjesëmarrësve të ndahen në grupe me dy ose më shumë dhe të diskutojnë mënyrat se si ata mund të ndihmojnë të tjerët të mbështeten tek vetja. I ftoni të shënojnë se çfarë do të përpiqen të bëjnë si rrjedhojë e këtij mësimi.

Jepni dëshmi të bekimeve që vijnë kur individët jetojnë me parimet e mbështetjes tek vetja.

Emri i anëtarit

Adresa

Telefoni

Lagjia

Kunji

Ku punësohet

Profesioni

Telefoni

Emrat dhe mosha e anëtarëve të familjes që i ka në ngarkim

Udhëzime

Peshkopi e ndihmon individin me nevojat më urgjente ndërsa komiteti i lagjes për mirëqenien, përfshirë udhëheqësit e kuorunit të priftërisë dhe udhëheqëset e Shoqatës së Ndhmës, ndihmojnë me anë të një plani që çon në mbështetjen te vetja.

1. Përcaktoni nevojat individuale dhe familjare.
2. Përcaktoni burimet individuale, familjare dhe të Kishës.
3. Ndihmoni anëtarin të hartojë një plan për t'u bërë i pavarur.
4. Caktoni detyra kështu që ai që merr ndihmën mund të punojë me gjithë aftësinë e tij apo të saj.

Nevojat Urgjente

Përcaktoni me anëtarin nevojat e tij/saj urgjente. Nevojat duhet të renditen më poshtë dhe mund të përfshijnë: ushqim, veshje dhe strehim; para për fatura mjeksore dhe shërbime publike; ose nevoja të tjera.

Burime për të Plotësuar Nevojat Urgjente

Burime nga individit, familja, komiteti i lagjes për mirëqenien, burime të tjera nga Kisha dhe komuniteti.

1. Burimet e Individit

2. Anëtarët e familjes dhe si mund të ndihmojnë ata (prindër, fëmijë, motra e vëllezër, etj)

3. Burime të tjera dhe si mund të ndihmojnë ato

Çfarë Nevojitet Për Mbështetjen te Vetja

Bashkë me anëtarin përcaktoni se çfarë nevojitet për t'u bërë i pavarur. Nevojat duhet të renditen më poshtë dhe mund të përfshijnë, strehim, punësim, trajnim për punë, arsim etj.

Plani për Plotësimin e Nevojave të Mbështetjes te Vetja

Së bashku me anëtarin hartoni një plan për mbështetjen te vetja i cili përfshin mënyra se si të sigurohen burimet e nevojshme dhe koha kur ato do të jenë në dispozicion.

Puna ose Shërbimi që do të Kryhet Shënoni më poshtë detyrat që anëtarët e familjes kanë pranuar që të punojnë me gjithë aftësitë e tyre për produktet dhe shërbimet që marrin.

Nënshkrimet

Nënshkrimi i anëtarit

Data

Nënshkrimi i Peshkopit

Data

Shënim: Në këtë formular termat *peshkop* dhe *lagje* i referohen gjithashtu edhe presidentit të degës dhe degës.

32290 101